

# KARTA E AB TË BASHKISË KORÇË

## 1. Objekti i kartës së auditimit të brendshëm :

Karta e Auditimit të Brendshëm është dokumenti që përshkruan:

➤ *Statusin organizativ të njësisë së auditimit të brendshëm;*

Struktura dhe organizimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm miratohet me Vendim të Këshillit Bashkiak si pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Korçë. Kjo njësi ka varësi organizative dhe funksionale nga Kryetari i bashkisë. Aktualisht struktura është e miratuar me 1 Drejtor dhe 3 Inspektorë të lartë të AB.

➤ *Qëllimin, misionin dhe objektin e punës së auditimit të brendshëm;*

Kryerja e një veprimtarie të pavarur auditimi, për të dhënë siguri objektive menaxhimit dhe këshilluar drejtimin, për përdorimin efektiv të burimeve, duke ndihmuar në mënyrë sistematike dhe të programuar në përmirësimin e efijencës, menaxhimit të riskut, kontrollit dhe proceseve, të drejtimit dhe të qeverisjes.

➤ *Pavarësinë dhe rregullimet ligjore që sigurojnë pavarësinë;*

Audituesit e Brendshëm kryejnë angazhimet në mënyrë që të kenë besim për sa i përket produktit të punës të tyre dhe të mos bëjnë ndonjë kompromis për sa i përket cilësisë.

***Punonjësit e Auditimit të Brendshëm kanë pavarësi funksionale dhe organizative.***

Pavarësia Funksionale nënkupton se strukturat e auditimit janë të pavarura në planifikimin, kryerjen dhe raportimin e rezultateve të auditimit nga subjekti që auditohet. Kryerja e auditimit duhet të zhvillohet sipas kuadrit ligjor e rregullator dhe standardeve të miratuara dhe nuk i nënshtrohet asnjë ndikimi tjetër nga individë me autoritet, qofshin këta brenda apo jashtë sistemit të Bashkisë Korçë. Audituesit respektojnë strukturat në njësinë që auditohet, rregullat e etikës dhe sjelljes në shërbimin civil.

Pavarësia Organizative brenda njësisë nënkupton që inspektorët e auditimit raportojnë te Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe nëpërmjet tij, raportohet drejtpërdrejt te Kryetari i Bashkisë. Ata nuk mund të angazhohen në detyra të tjera brenda njësisë të cilat nuk lidhen me funksionet e Auditimit të Brendshëm. Drejtorja e Auditimit të Brendshëm është pjesë e strukturave të menaxhimit dhe jo e strukturave operacionale të Bashkisë Korçë.

Audituesit e Brendshëm duhet të mbajnë qëndrim të paanshëm dhe të shmangen konfliktit të interesit.

➤ *Rolin dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm, të drejtuesit dhe audituesve të saj dhe mënyrën se si realizohen ato;*

Njësia e Auditimit të Brendshëm të bashkisë Korçë është përgjegjëse për :

Hartimin e planeve vjetore dhe strategjike për veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

Kryerjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas udhëzimeve dhe metodave të miratuara nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, për të vlerësuar nëse sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si dhe performanca e njësisë së audituar janë transparente dhe në përputhje me normat e ligjshmërisë, të rregullshmërisë, të ekonomisë, efektivitetit dhe efijencës.

Ndjekjen dhe raportimin periodik për gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet, që rezultojnë nga veprimtaritë audituese, si dhe dhënia e informacionit për Njësia Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, për rekomandimet e pazbatuara nga drejtuesit e subjektit publik të audituar e për pasojat e moszbatimit të tyre.

Përgatitjen e raporteve, vjetore ose periodike, të cilat i dërgohen Njësia Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm dhe përmbajnë të dhëna për :

- Angazhimet dhe objektin e auditimit, të kryer gjatë periudhës së raportuar, kohëzgjatjen e çdo auditimi dhe, nëse ka pasur shmangie nga plani, arsyet dhe argumentet përkatëse.
- Përfundimet për funksionimin e sistemeve të kontrollit brenda bashkisw Korçw dhe institucioneve tw vartwsisw, së bashku me rekomandimet për përmirësim.
- Veprimet e ndërmarra nga menaxhimi për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar.

Raportimin, pas këshillimit me strukturën përkatëse juridike, te drejtuesi i subjektit të audituar dhe i njësisë së inspektimit, kur zbulon parregullsi apo veprime që përbëjnë vepër penale. Inventarizimin dhe arshivimin e dosjeve të auditimeve të kryera, korrespondencës së drejtorisë dhe raportimeve periodike e vjetore.

➤ *Autoritetin e auditimit të brendshëm;*

Drejtuesi i njësisë dhe stafi i auditimit janë të autorizuar, për të patur akses të plotë, të lirë dhe të pakufizuar tek të gjitha funksionet, regjistrat, pronat dhe personeli për kryerjen e çdo angazhimi auditimi me përgjegjësi në ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe informacionit. Të gjithë punonjësve, pjesë e njësisive publike duhet t'u kërkohet bashkëpunim për të ndihmuar njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e misionit, rolit dhe përgjegjësi të saj.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të ketë akses të lirë dhe të pakufizuar edhe tek njësitë shpenzuese si shoqëri aksionere, që funksionojnë me Këshilla Mbikqyrëse.

➤ *Përgjegjshmërinë, linjat e raportimit të drejtuesit të njësisë, mënyrat dhe format e raportimit;*

Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm në përmbushjen e detyrave të veta, është përgjegjës përpara menaxhimit që :

- Të japë vlerësime vjetore për Kryetarin e Bashkisë si drejtuesi i organizatës publike mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të risqeve të rëndësishëm, dhe për objektin e dokumentuar të punës audituese.
- Të raportojë rregullisht për dobësitë thelbësore të identifikuara nga auditimi, së bashku me rekomandime për përmirësimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm.
- Të informojë periodikisht menaxhimin e lartë mbi gjendjen dhe rezultatet e planit vjetor të auditimit dhe mjaftueshmërinë e burimeve të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.
- Të raportojë për rezultatet e shërbimeve këshillimore dhe konsulencës për menaxhimin e lartë, si një nga detyrat e tij të ngarkuara me ligj.
- Të koordinojë dhe mbikqyrë funksionet e tjera të kontrollit dhe ato monitoruese (menaxhimin e riskut, përputhshmërinë, sigurinë, ligjshmërinë, etikën, mjedisin, auditimin e jashtëm).

➤ *Standardet e praktikave të auditimit të përcaktuara në Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të kësaj veprimtarie.*

Përputhshmëria e veprimtarisë së AB të bashkisë Korçë me kërkesat e :

- Kodit të etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik, miratuar me urdhërin e Ministrit të Financave nr.86, dt.10.12.2015, dhe
- Standarteve ndërkombëtare për praktikën profesionale të AB, publikuar nga Drejtoria e harmonizimit për AB, sipas urdhërit të Ministrit të Financave nr.40, dt.08.05.2017,

përfshijnë të gjithë elementët e detyrueshëm të Kuadrit të Praktikave profesionale Ndërkombëtare.

## **2. Misioni :**

Kryerja e çdo angazhimi auditimi në përputhje me aktet ligjore e nëligjore në fuqi, standartet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranuar dhe shpallura nga Ministri i Financave dhe programeve strategjike dhe vjetore të miratuara nga Kryetari i Bashkisë.

Auditimi i brendshëm duhet të asistojë të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre, nëpërmjet analizave të pavarura, vlerësimeve, këshillimeve dhe rekomandimeve, lidhur me veprimet e ekzaminuara.

Auditimi ndihmon Bashkinë për të arritur objektivat e veta, me anën e një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e për të përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, proceset e kontrollit dhe të qeverisjes së bashkisë.

## **3. Objekti i punës dhe veprimtaria e auditimit të brendshëm ;**

Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të kryhet duke respektuar përkufizimin e auditimit të brendshëm, Kodin e Etikës, Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të publikuara nga Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA) dhe të pranuar për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë. Këto udhëzues, përbëjnë parimet dhe kërkesat themelore për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, në vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrolleve të brendshme dhe performancës së veprimtarisë audituese.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm do t'i përmbahet edhe politikave, procedurave metodave të auditimit, si pjesë e manualit Standard të Auditimit të Brendshëm.

Kryerja e auditimit të brendshëm në të gjitha subjektet e sistemit të Bashkisë Korçë, për të gjitha strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset, përfshirë dhe veprimtaritë me burimet e fondet e Bashkimit Evropian.

Përcaktimi nëse sistemi i Bashkisë Korçë për proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes të hartuara dhe paraqitura nga menaxhimi, janë adekuate dhe funksionojnë në atë mënyrë sa që garanton se:

- Risqet identifikohen dhe menaxhohen në mënyrën e duhur.
- Ndërveprimi me grupet e ndryshme të qeverisjes ndodh sipas nevojës dhe me efektivitet.
- Informacioni thelbësor financiar, menaxherial dhe operacional është i saktë, i besueshëm dhe në kohë.
- Veprimet e punonjësve janë në përputhje me politikën, standartet, procedurat dhe ligjet e rregulloret e zbatueshme.
- Burimet sigurohen me ekonomikitet, përdoren me efikasitet dhe mbrohen në mënyrë adekuate.
- Realizohen programet, planet dhe objektivat.
- Cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm janë integruar në procesin e kontrollit të brendshëm.
- Çështjet e rëndësishme legjislative ose rregullatore që kanë ndikim në njësi janë pranuar dhe adresuar siç duhet.

## **4. Autoriteti :**

Drejtuesi i njësisë dhe stafi i auditimit janë të autorizuar :

- Të kenë akses të pakufizuar tek të gjitha funksionet, rregjistrat, pronat dhe stafin e institucionit të bashkisë e institucioneve të vartësisë.
- Të shpërndajnë burimet, të vendosin frekuencat, të përzgjedhin fushat, tematikat, të përcaktojnë objektin e punës dhe të aplikojnë teknikat e kërkuara për të realizuar objektivat e auditimit.
- Të ushtrojnë në mënyrë të pavarur funksionin e auditimit, pa lënë hapësirë për ndërhyrje nga kolegët, mbikëqyrësit, drejtuesit e njësisë së auditimit apo pala e audituar, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjella të këshillimit.

- Të kërkojnë të gjitha të dhënat me karakter teknik, ekonomik e financiar dhe të drejtimit për subjektin që auditohet, duke marrë përsipër ruajtjen e fshehtësisë së informacionit, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të marrin nga punonjësit e subjektit të audituar, për rastet që gjykohet e nevojshme, shpjegime, deklarata dhe fotokopje të dokumenteve, në të cilat drejtuesi i subjektit të audituar ka vënë shënimin “e njëjtë me origjinalin”, si dhe materiale të transportueshme, në formë elektronike, që kanë lidhje me auditimin e brendshëm të subjektit.
- T’i paraqesin kërkesën drejtuesit të njësisë së auditimit për heqjen dorë nga një veprimtari auditimi, kur çmojnë se për shkaqe të argumentuara cënohen besueshmëria dhe cilësia e auditimit.
- Të kërkojnë ti ofrohet asistenca dhe bashkëpunimi i nevojshëm nga personeli i njësisë që auditohet gjatë zhvillimit të veprimtarisë së auditimit, si dhe shërbime të tjera të specializuara nga brenda ose jashtë subjektit që auditohet.
- Audituesit e brendshëm zbatojnë parimet e ligjshmërisë, pavarësisë, paanësisë dhe fshehtësisë.
- Audituesit në çdo kohë duhet të pasqyrojnë integritet moral dhe profesional dhe të respektojnë Kodin e Etikës.

#### **Kufizimet :**

Drejtuesi i njësisë dhe stafi i auditimit nuk janë të autorizuar :

- Të kryejnë asnjë detyrë operacionale brenda **Bashkisë Korçë**.
- Të jenë të zgjedhur në funksione drejtuese në strukturat e partive politike.
- Të ushtrojnë çdo veprimtari ose punë tjetër me pagesë, ose të kenë përfitime të tjera, të natyrave dhe formave që i bëjnë të jenë në konflikt interesash me ushtrimin e auditimit.
- Të krijojnë ose miratojnë transaksione të llogarisë etj, që janë jashtë drejtorisë të AB.
- Të drejtojnë veprimtaritë e punonjësve që nuk janë punësuar nga njësia e Auditimit të Brendshëm, përveçse kur këta punonjës janë caktuar në grupet e auditimit sipas nevojës, ose në ndonjë mënyrë tjetër për të ndihmuar Audituesit e Brendshëm.

#### **5. Organizimi :**

Drejtuesi i njësisë së auditimit do të raportojë tek Kryetari i bashkisë, i cili do të miratojë:

- a) Kartën (statuti) e auditimit të brendshëm;
- b) Planet e auditimit të brendshëm vjetor dhe strategjik dhe planet (programet) e angazhimit;
- c) Buxhetin dhe burimet e auditimit;
- d) Performancën e veprimtarisë së njësisë së auditimit të brendshëm dhe çështje të tjera;
- e) Vendime në lidhje me emërimin dhe shkarkimin e drejtuesit të njësisë së auditimit.
- f) Kryerjen e veprimeve me natyrë investiguese, mbi veprimtaritë e rëndësishme brenda njësisë publike të dyshuara për mashtrim, dhe për këtë drejtuesi të njoftojë Kryetarin e bashkisë.

Drejtuesi i njësisë së auditimit do të komunikojë dhe ndërveproje direkt me kryetarin e bashkisë.

#### **6. Pavarësia dhe objektiviteti :**

Eshtë shumë e rëndësishme që audituesit të jenë të pavarur, por gjithashtu edhe të shihen nga të tjerët si të pavarur.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm duhet të jetë e lirë nga ndërhyrjet në lidhje me çështjet e zgjedhjes së auditimit, fushëveprimin, procedurat, frekuencën, kohën, apo përmbajtjen e raportit, të cilat lejojnë mbajtjen e një qëndrimi të nevojshëm të pavarur dhe objektiv.

Audituesit e brendshëm nuk do të kenë përgjegjësi të drejtpërdrejtë operacionale apo autoritet mbi ndonjë nga aktivitetet e audituara. Ata nuk do të jenë përgjegjës për zhvillimin apo implementimin e detajuar të sistemeve të reja, por mund të japin këshillime.

Audituesit e brendshëm do të shfaqin nivelin më të lartë të objektivitetit profesional në grumbullimin, vlerësimin, dhe komunikimin e informacionit në lidhje me aktivitetin ose procesin, që janë duke shqyrtuar. Audituesit e brendshëm duhet të bëjnë vlerësim të balancuar të të gjitha sistemeve/fushave që auditohen dhe nuk ndikohen nga interesat e tyre, ose nga të tjerët në formimin e gjykimeve.

Drejtuesi i njësisë së auditimit, do t'i konfirmojë kryetarit të bashkisë, të paktën çdo vit, pavarësinë organizative të veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Ky konfirmim do të kryhet nëpërmjet nënshkrimit, çdo vit, të Deklaratës së Objektivitetit, Paanësisë dhe Kompetencës, nga çdo auditues. Deklarata t'i bashkëngjitet dokumentave të planit vjetor.

Për të treguar se janë të pavarur dhe objektivë, audituesit e brendshëm do të plotësojnë për çdo angazhim, Deklaratën e Pavarësisë së Auditimit, e cila bëhet pjesë e dosjes së auditimit.

## **7. Përgjegjësia :**

Përcaktimi i sistemeve/fushave që do të mbulohen me auditim duhet të jetë gjithëpërfshirës për të mundësuar ekzaminimin efektiv dhe të rregullt të të gjithë veprimtarive operacionale, financiare dhe të lidhura, por nuk mund të jetë subjekt i ndonjë kufizimi brenda bashkisë.

Për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara nga bashkia, do të vlerësohet përshtatshmëria dhe efektiviteti i qeverisjes, rrezikut të menaxhimit të bashkisë dhe kontroleve të brendshme, si dhe cilësia e performancës për kryerjen e përgjegjësiave të caktuara.

Kjo përfshin:

- a) Vlerësimin e ekspozimit ndaj riskut në lidhje me arritjen e objektivave strategjike të bashkisë.
- b) Vlerësimin e besueshmërisë dhe integritetin e informacionit dhe mjetet e përdorura për të identifikuar, matur, klasifikuar, dhe për të raportuar një informacion të tillë.
- c) Vlerësimin e sistemeve të vendosura për të siguruar përputhjen me politikat, planet, procedurat, ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kenë ndikim të rëndësishëm në bashkinë Korçë.
- d) Vlerësimin e mjeteve dhe ruajtjen e pasurisë verifikimin e ekzistencës së aktiveve të tilla.
- e) Vlerësimin e efektivitetit dhe efikasitetin me të cilën burimet janë përdorur.
- f) Vlerësimin e operacioneve apo programeve për të vërtetuar nëse rezultatet janë në përputhje me objektivat e vendosura, dhe nëse operacionet ose programet janë duke u kryer sipas parashikimeve.
- g) Monitorimin dhe vlerësimin e proceseve të qeverisjes.
- h) Monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit të proceseve të menaxhimit të riskut të bashkisë.
- i) Vlerësimin e cilësisë së performancës së audituesve të brendshëm pjesë e grupit të auditimit.
- j) Kryerjen e konsultimit dhe shërbimeve këshilluese në lidhje me qeverisjen, menaxhimin e riskut dhe kontrollin, si objektiva të përshtatshme për njësinë.
- k) Raportimin periodik për veprimtarinë e auditimit të brendshëm lidhur me qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe të performancës, në lidhje me planin e tij.
- l) Raportimin e rëndësishëm që ekspozimi ndaj riskut dhe çështjet e kontrollit, duke përfshirë rreziqet e mashtrimit, çështjet e qeverisjes, si dhe çështje të tjera të nevojshme apo të kërkuara nga titullari, janë adresuar saktë.
- m) Vlerësimin e përshtatshmërisë së operacioneve të veçanta me kërkesë të kryetarit të bashkisë.

## **Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.**

Si drejtues i njësisë ka detyra e përgjegjësi :

1. Organizimin e anagazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standarteve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.
2. Programimin e veprimtarive të drejtorisë sipas frekuencave, bazuar në vlerësimin e riskut dhe funksionimin e sistemeve brenda bashkisë apo në njësitë e vartësisë.

3. Hartimin e planeve vjetore e strategjike, përditësimin e tyre, miratimin tek titullari dhe dërgimin brënda afateve të parashikuara në ligj.
4. Përgatitjen e raportit vjetor, i cili dërgohet në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e AB me të dhëna për angazhimet e kryera gjatë periudhës së raportuar, shmangiet nga plani, arësyet dhe argumentet, vlerësimin për sistemet e kontrollit brënda bashkisë dhe në institucionet e vartësisë, veprimet e ndërmarra nga titullari për zbatimin e rekomandimeve.
5. Përputhjen e veprimtarive me burimet materiale e njerëzore të drejtorisë dhe parashikimin e nevojave të stafit për trajnim.
6. Përpilimin e autorizimit për fillimin dhe përgatitjen e misionit të auditimit, ku caktohet grupi i auditimit.
7. Miraton ose jo sipas rastit, deklaratën e pavarësisë së audituesve.
8. Prezanton grupin e auditimit në takimin fillestar me subjektin që auditohet.
9. Miraton ndryshimet e mundshme në projektprogramin e angazhimit pas takimit fillestar me subjektin.
10. Realizon rishikimin e cilësisë për çdo mision auditimi për të siguruar se angazhimi përmbush standartet dhe është i dobishëm për subjektin e audituar.
11. Merr pjesë në takimin përfundimtar me subjektin e audituar për të dëgjuar mendimet dhe komentet në lidhje me gjetjet e rekomandimet e paraqitura.
12. Nënshkruan shkresën për mbylljen e angazhimit dhe dërgon atë zyrtarisht subjektit të audituar.
13. Dërgon informacion për NA në fillim të çdo viti mbi gjendjen dhe cilësinë e KB në strukturat e kontrolluara dhe për rekomandimet e dhëna në këtë drejtim.
14. Merr pjesë në mbledhjet e GMS-së, pa të drejtë vote.
15. Si auditues në përbërje të grupi të auditimit ka detyra e përgjegjësi të përcaktuara në detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektorit të lartë të Auditimit të Brendshëm ( nga 1-17).
16. Dorëzimi dhe arkivimi i dokumentacionit të drejtorisë në arkivën e institucionit, sipas ligjit për arkivat.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektorit të lartë i Auditimit të Brendshëm.**

1. Të njohë, të respektojë dhe të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me standartet e auditimit të brendshëm në sektorin publik.
2. Të ushtrojë funksionet e tij në mënyrë objektive, me profesionalizëm dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit, sipas normave dhe procedurave të veçanta të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik.
3. Të veprojë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës, Kartën e Auditimit dhe rregullat për konfidencialitetin për audituesin.
4. Të kryejë auditime në mënyrë të pavarur, nga pikëpamja profesionale, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit.
5. Të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me planin vjetor të miratuar, me përjashtim të rasteve kur janë miratuar ndryshime të paparashikuara nga titullari.
6. T'i propozojë drejtuesit të njësisë së auditimit dhe, nëpërmjet tij, drejtuesit të subjektit, pezullimin deri në shqyrtimin nga organi përkatës të veprimeve të kundërligjshme, të cilat dëmtojnë rëndë interesat e subjektit dhe/ose janë të arsyetuara e përbëjnë vepër penale.
7. T'i japë rekomandime subjektit të audituar për ndreqjen e parregullsive, për masat që duhen ndërmarra në rastet e dëmeve ekonomike dhe financiare për zhdëmtimin e tyre, si dhe të bëjë propozime, të cilat synojnë të ulin mundësinë e përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen.
8. Të mos bëjë publike asnjë të dhënë, fakt apo rast të gjetur gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajnë dokumentet për çdo veprimtari auditimi të kryer, bazuar në

detyrimet që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar.

9. Të përditësojë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që t'i përdorë me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit.
10. Të ushtrojë në mënyrë të pavarur funksionin e auditimit, pa lënë hapësirë për ndërhyrje nga kolegët, mbikëqyrësit, drejtuesit e njësisë së auditimit apo pala e audituar, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjella të këshillimit.
11. Të kërkojë të gjitha të dhënat me karakter teknik, ekonomik e financiar dhe të drejtimit për subjektin që auditohet, duke marrë përsipër ruajtjen e fshehtësisë së tyre, sipas legjislacionit në fuqi.
12. Të marrë nga punonjësit e subjektit të audituar, për rastet që gjykohet e nevojshme, shpjegime, deklarata dhe fotokopje të dokumenteve, në të cilat drejtuesi i subjektit të audituar ka vënë shënimin "e njëjtë me origjinalin", si dhe materiale të transportueshme, në formë elektronike, që kanë lidhje me auditimin e brendshëm të subjektit.
13. Të ndjekë, në mënyrë periodike, edukimin e përditësuar dhe trajnimin e vazhdueshëm të detyrueshëm, sipas kërkesave të nenit 20 të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", për funksionet e veçanta që ushtron, si dhe në fusha të tjera brenda shërbimit publik.
14. T'i paraqesë kërkesën drejtuesit të njësisë së auditimit për heqjen dorë nga një veprimtari auditimi, kur çmojnë se për shkaqe të argumentuara cenohen besueshmëria dhe cilësia e auditimit.
15. I ndalohet të mbajë një mandat politik apo të jetë i zgjedhur në funksione drejtuese në strukturat e partive politike.
16. I ndalohet të kryejë detyra, brenda subjektit të audituar, që nuk kanë të bëjnë me funksionin e auditimit të brendshëm në sektorin publik.
17. I ndalohet të ushtrojë çdo veprimtari ose punë tjetër me pagesë, ose të ketë përfitime të tjera, të natyrave dhe formave që e bënë të jenë në konflikt interesash me ushtrimin e auditimit.
18. Njofton paraprakisht, me shkrim, drejtuesin e njësisë së auditimit të brendshëm për çdo konflikt të mundshëm interesi, që rrjedh nga pjesëmarrja e tij në auditimin e një subjekti.

#### **8. Plani i auditimit të brendshëm :**

Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm pas konsultimit me menaxhimin e lartë, çdo vit, do t'i paraqesë kryetarit të bashkisë një plan auditimi të brendshëm për shqyrtim dhe miratim. Plani i auditimit të brendshëm jep një informacion mbi punën që do të kryejë njësia e auditimit gjatë një viti, dhe përfshin kërkesat për buxhetin dhe burimet që do të përdoren gjatë vitit të ardhshëm kalendarik.

Drejtuesi i njësisë së auditimit do të komunikojë ndikimin e kufizimeve të burimeve, si dhe ndryshimet e rëndësishme të planit tek kryetari i bashkisë.

Plani i auditimit të brendshëm do të zhvillohet në bazë të prioritetit të universit të auditimit, duke përdorur metodologji që bazohet në vlerësimin e riskut, duke përfshirë edhe kontributin e kryetarit të bashkisë apo kërkesave të titullarëve të njësive të vartësisë.

Drejtuesi i njësisë së auditimit, do të shqyrtojë dhe rregullojë planin, sipas nevojës, në përgjigje të ndryshimeve të aktivitetit të bashkisë, rreziqeve, operacioneve, programeve, sistemeve, dhe kontrolleve. Çdo devijim i rëndësishëm nga plani i aprovuar i auditimit të brendshëm do t'i komunikohet kryetarit të bashkisë veprimtarisë raportuese periodike.

#### **9. Raportimi dhe monitorimi :**

Një raport i shkruar (Raporti final) do të përgatitet dhe lëshohet nga drejtuesi i njësisë së auditimit ose i caktuari prej tij, në përfundim të auditimeve dhe rezultatet e tij do të shpërndahen në funksion të qëllimit.

Raporti i auditimit të brendshëm mund të përfshijë përgjigjet dhe veprimet korigjuese të ndërmarra nga menaxhimi ose që do të merren në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet specifike, dhe janë konfidencialë për palët e treta që nuk përfshihen në raport.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të jetë përgjegjëse për të gjitha gjetjet e angazhimit dhe zbatimin e rekomandimeve. Të gjitha gjetjet e rëndësishme do të mbahen në një skedar si çështje të hapura deri sa ato të zbatohen plotësisht.

Drejtuesi i njësisë së auditimit do të raportojë periodikisht për kryetarin e bashkisë, për çdo anagazhim auditimi, nëpërmjet Memorandumit. Gjithashtu ai raporton tek kryetari i bashkisë mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm qëllimin, autoritetin, përgjegjësitë, si dhe performancën e saj. Raportimi do të përfshijë ekspozimet ndaj rreziqeve dhe çështjeve të kontrollit, duke përfshirë edhe rreziqet e mashtrimit, çështjet e qeverisjes, si dhe çështje të tjera të nevojshme apo të kërkuara nga kryetari i bashkisë.

#### **10. Sigurimi i cilësisë dhe programi i përmirësimit :**

Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të mbajë një program të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit që mbulon të gjitha aspektet e aktivitetit të auditimit të brendshëm. Programi do të përfshijë një vlerësim të përputhshmërisë të veprimtarisë së auditimit të brendshëm me Përkufizimin e Auditimit të Brendshëm, Standardet dhe Kodin e Etikës. Programi gjithashtu vlerëson efikasitetin dhe efektivitetin e aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm do të komunikojë me titullarin e bashkisë, lidhur me implementimin dhe sigurimin e cilësisë dhe programit të përmirësimit, duke përfshirë rezultatet e vlerësimit e vazhdueshme të brendshme dhe vlerësime të jashtme, të cilat duhet të kryhen të paktën në çdo 5 vjet.

Drejtoria e Auditimit do të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet Vetëvlerësimit periodik për çdo auditim dhe plotësimin të Reagimeve të subjektit të audituar (Feedback-u), formatet e të cilave do të jenë pjesë e dosjes së auditimit.

#### **Karta e Auditimit të Brendshëm**

Miratuar me Urdhërin nr.631, datë: 27 /09 / 2017

Drejtuesi i Njësisë së AB

Athinulla TREBICKA

Kryetari i bashkisë

Sotiraq FILO